

REGULLA TË REJA PËR PËRJASHTIMIN NGA PAGESA E SHËRBIMIT SHËNDETËSOR TË NDIHMËS SË SHPEJTË

Çfarë duhet të dimë...

Krahina Emilia-Romagna ka përcaktuar me vendimin 1035/2009 dhe me modifikime të mëtejshme (vendimi n. 389/2011), pagesën dhe kriteret e përjashtimit nga pagesa e shërbimit shëndetësor që jep Ndhimja e Shpejtë. Rregullat e reja kanë si qëllim të sigurojnë një përdorim korrekt të kësaj strukture..

Duke filluar nga data 26 shtator 2009 nuk paguhen këto shërbime shëndetësore që jep Ndhimja e Shpejtë:

- Shërbimet për gjëndjet klinike që paraqesin nevojën ti nënshtrohen një iteri dignostikues e kurues që zgjat jo më pak se 6 orë dhe jo më shumë se 24 orë;
- Shërbimet që shoqërohen me shtrimin në spital - shërbimet e para për trauma me paraqitje në Ndimën e Shpejtë brenda 24 orëve nga ndodhja e faktit;
- Shërbimet për trauma me paraqitje në Ndhimën e Shpejtë mbas 24 orëve nga ndodhja e faktit, në rastet kur fillohet një ndërhyrje kuruese;
- Shërbimet për helmime akute;
- Shërbimet për personat nën moshën 14 vjeç;
- Shërbimet për aksidentet në punë - shërbimet e kërkuara nga mjeku dhe pediatri i familjes, nga mjeku i rojes ose nga mjekët e një strukture tjetër të Ndhimës së shpejte;
- Shërbimet për personat që janë të përjashtuar nga pagesa për arsye të sëmundjeve që kanë, për të ardhura të pakta ose për arsye të tjera të parashikuara nga normativa në fuqi;
- Shërbimet për personat e huaj që ndodhen përkohësisht në Itali (STP) nëse janë të sëmurë e sipas normave në fuqi;

Nga muaji maj 2011 (vendimi n. 389/2011) përjashtohen nga pagesa patollogjitë e mëposhtme:

- kolikë e veshkave, kriza azme, dhimbje kraharori, aritmi të zemrës, glaukomë akute, kur të ka hyrë diçka në sy, rjedhje gjaku nga hunda, kur të ka hyrë diçka në vesh, komplikacione të ndërhyrjeve kirurgjike që detyrojnë personin të paraqitet në Ndhimën e Shpejtë brenda tre ditësh nga dalja nga spitali, probleme dhe simptoma të lidhura me shtatzaninë.

Për informacione të mëtejshme telefononi falas në numrin jeshil të Shërbimit Shëndetësor Krahinor **800 030 033** (në ditët e punës nga ora 8,30 deri në orën 17,30 dhe të shtunën nga ora 8,30 deri në orën 13,30).